

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË “ TOPCLEAN ” SHPK**

Sot, më datë 04.10.2024 (dymijë e njëzetë e katër ), në praninë e Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë “ **TOPCLEAN**” SHPK si më poshtë:

Ortak i Vetëm Themelues i shoqërisë “TOPCLEAN” SHPK, është Znj. Rezalda Shehi, e bija e Fadil, e datëlindjes 12 qershor 1981 shtetas shqiptar, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal I15612066D, dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e cila me me vullnetin e saj të plotë të lirë e të pacenuar

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “**TOPCLEAN**” SHPK, me kushtet si vijon:

**NENI 1**  
**Emri i shoqërisë**

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “TOPCLEAN” SHPK.
- 1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë.

**NENI 2**  
**Forma e shoqërisë**

- 2.1. Forma e shoqërisë “TOPCLEAN” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

**NENI 3**  
**Selia e shoqërisë**

- 2.3. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Tiranë, Rruga Deshmoret e 4 Shkurtit, Nr. apartamenti 7, kati 2 , Numri i Pasurise 4/82-N7,, Tiranë
- 2.4. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.



**NENI 4**  
**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

- 2.5. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 2.6. Ortaku i Vetëm/ Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

**NENI 5**  
**Objekti i veprimtarisë**

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: Veprimtari ekonomike në fushën e Sherbime Pastrimi, Kompani Pastrimi, Pastrim Shtepiash, Pastrim Zyrash, Larje Divanesh, Larje Dyshekesh, Larje Kolltuqesh, Larje Divane, Larje Dysheku, Pastrim, si dhe çdo veprim tjetër i ligjshëm.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë**

- 2.7. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) lekë.
- 2.8. Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 2.9. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortaku i vetëm themelues.

**NENI 7**  
**Organet Drejtuese**

- 2.10. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:
- 1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm** — organi më i lartë vendimmarrës;
  - 2. Administratori** — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 2.11. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

**NENI 8**  
**Administrimi**

- 2.12. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.



- 2.13. Administratori i Shoqërisë “**TOPCLEAN**” SHPK do të jetë, Znj. Alma Telushi, e bija e Kujtim, e datëlindjes 23 Janar 1991 shtetas shqiptar, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, identifikuar me nr personal J15113070W, madhor, dhe me zotësi të plotë për të vepruar, e cila emërohet për mandat me afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.
- 2.14. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

**NENI 9**  
**Ligji i aplikueshëm**

- 2.15. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

**NENI 10**  
**Regjistrimi**

- 3.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**NENI 11**  
**Dispozitat përfundimtare**

- 11.1 Ky Akt Themelimi përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues.

**ORTAKU I VETËM THEMELUES I**  
**SHOQËRISË “TOPCLEAN” SHPK**  
**Përfaqesuar nga**

**Znj. Rezalda Shehi**

